

Shpallje për auditor të jashtëm

Në bazë të nenit 8 të kontratës PPP dhe në pajtim me dispozitat ligjore, shpallim këtë tender për veprimtarinë e auditorit të jashtëm për bilancin 2017 të Eco-Higjiena sh.p.k.

Kompania Eco-Higjiena sh.p.k. është themeluar në vitin 2012 dhe që nga 01.07.2012 është aktive. Kompania jonë është një PPP, sipas Ligjit 03/L-090 të Republikës së Kosovës. Partnerët tanë janë me 51 % Moser-Group nga Austria dhe me 49 % Komunitat Gjilan, Viti dhe Kamenicë. Ne ushtrojmë aktivitet të shërbimit publik në grumbullim të mbetjeve urbane dhe punësojmë 145 punëtor me një qarkullim prej 1,5 milion €.

Lënda e shpalljes:

Auditimi i bilancit për vitin 2017 dhe pregaditja e një raporti të auditimit sipas standardeve kosovare dhe internacionale për Kuvendin e Akcionarëve në 2 gjuhë : shqip – gjermanisht ose shqip - anglisht.

Detyrat zbatuese:

Kontrollimi i bilancit dhe kontabilitetit në kuptim të plotësueshmërisë, korrektësisë, riskun e mundshëm dhe harmoninë me dispozitat dhe ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

Kohëzgjatja e zbatimit:

Deri më 30 prill 2018

Dokumentat e aplikueshmërisë:

- Një ofertë me shkrim me çmim të fiksuar dhe produkt standard të kompanisë
- Kompania duhet të jetë e regjistruar në ARBK-në;
- Së paku kompania duhet të ketë dy auditor ligjorë;
- Në staf duhet të jenë 3 auditor për të perfunduar punën me suksesë;
- Së paku 3 referenca në lidhje me punët e kryera, në 3 vitet e fundit në lidhje me auditim të komunave ose kompanive me bashkëpjesmarrje internacionale ose kompani nga lomia e shërbimeve publike;
- Një vërtetim nga Gjykata Ekonomike se biznesi nuk është delikuent;
- Një deklaratë me shkrim për secilin antarë të kompanisë audituese se nuk kanë vendim të plotfuqishëm nga gjykata në lidhje me ndonjë vepër penale;

Afati i aplikimit:

Ofertat aplikuese të plotësuara me të gjitha shtojcat duhet të dorëzohen më së largu deri më 30 Nëntor 2017 në ora 14:00 dhe hapja e tenderit do të jetë më 30 Nëntor 2017 në orën 14:30 në adresë të kompanisë Eco-Higjiena sh.p.k.; Fehmi Agani 17, 60000 Gjilan

Për çdo pyetje në lidhje me këtë tender ju lutem kontaktoni në e-mail: office@ecohigjiena.com

Kriteret e përzgjedhjes:

Përzgjedhja e ofertuesit të bëhet më çmim më të ulët dhe performancë më të mirë

Dhënja e tenderit :

Vendimi do të merret nga përfaqësuesit e akcionarëve në dhjetor 2017.